

- **Rishikimi i rregullores së Komitetit Kombëtare të Sistemit të Pagesave**

Nëpërmjet rishikimit të rregullores së KKSP janë arritur objektivat në lidhje me zgjerimin dhe përfshirjen e angazhimit të aktorëve të tregut. Këto rishikime kanë përbushur masta e parashikuara në planin e veprimit si vijon:

Përfshirja e angazhimit të aktorëve	Zgjerimi i anëtarësimit të KKSP-së për të përfshirë si anëtare me të drejtë vote IFJB të licencuara për të ofruar shërbime pagesash.
	Promovim sa më i madh i përfshirjes së sektorit privat në vendimet me interes të përbashkët dhe rëndësi publike, për sa i përket tregut kombëtar të pagesave me vlerë të vogël.

- [Vendim 24/2018 Për disa ndryshime në rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave"](#)

- **Miratimi i ligjit “Për shërbimet e pagesave” (PSD2) i cili transponon direktivën e rishikuar të Bashkimit Evropian 2015/2366.**

Ky ligj, nëpërmjet ridimensionimit të aktiviteteve **financiare jo banka të cilat ofrojnë shërbime pagesash dhe transfertash** aktualisht (por dhe ato që do të hyjnë në treg potencialisht) dhe lejimit të hapjes së llogarive nga ana e tyre (aktualisht e ndaluar nga kuadri ligjor në fuqi “Per Bankat në Republikën e Shqipërisë” i cili e klasifikon çdo teprice kreditore si depozitë) si dhe emetimin e instrumenteve elektronike të pagesave, vlerësohet se do të ketë ndikim në rritjen e popullsisë e cila zotëron një llogari për të kryer pagesa. Më konkretisht, nëse qytetarët aktualisht përdorin Postën Shqiptare, Western Union, Money Gram për të kryer dhe marrë pagesa por nuk kanë mundësi të kenë një llogari pranë këtyre institucioneve, me ligjin 55/2020 “Për shërbimet e Pagesave” kjo gjë jo vetëm që bëhet e mundur por njëkohësisht nxit edhe përdorimin e pagesave elektronike nëpërmjet këtyre llogarive. Duke marrë në konsideratë faktin se këto lloje institucioneve kanë një prezencë të gjerë gjeografike edhe në zonat rurale, vlerësohet se impakti në përfshirjen financiare do të jetë i lartë.

Ligji gjithashtu krijon mundësinë e bashkëpunimit të bankave me institucionet financiare jo banka, çka ndihmon në prezencën më të gjerë të bankave në të gjithë territorin e vendit. Ndikim në përfshirjen financiare do të ketë dhe kuadri prudencial për mbrojtjen e konsumatorit që krijon ky ligj, si dhe hapësirat e krijuara nga shërbimet inovative që instrumentet elektronike të përdoren edhe në përditshmërinë e publikut të gjerë. Objektivat e arritura nëpërmjet miratimit të Ligjit dhe akteve nënligjore në zbatim përbushin masat e planit të veprimit si vijon:

<p>Konsolidimi i mjedisit rregullator lehtësues për pagesat me vlerë të vogël</p>	<p>Rregullore gjithëpërfshirëse të agjentëve dhe nënagjentëve për ofrimin e shërbimit të pagesave dhe shërbimeve të lidhura me to.</p>
	<p>Rregullim në mënyrë të qëndrueshme i përdorimit të nënkontraktimit të shërbimeve nga palë të treta në të gjithë sektorin e pagesave, me fokus të veçantë në përdorimin e ofruesve të shërbimit teknik.</p>
	<p>Rishikim i bazave ligjore rregullore dhe mbikëqyrëse të BSH-së (d.m.th., në nivel statutor) për t'i shtrirë shprehimisht këto rregulla mbi shërbimet e pagesave.</p>
	<p>Krijimi i një zyre/agjencie me të drejtën dhe përgjegjësinë për të monitoruar dhe zbatuar mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve të pagesave dhe shërbimeve të tjera financiare.</p>
<p>Zgjerim i pikave të aksesit dhe rrjeteve të pagesave</p>	<p>Të zhvillohen agjentët bankarë. Përveç përgatitjes së ndryshimeve rregullore, të nxitet Posta Shqiptare dhe SHKK-të të bëhen agjentë për bankat</p>
<p>Të rritet konkurrenca me kosto efektive, duke shfrytëzuar programet e pagesave me vëllim të madh</p>	<p>Të rritet konkurrenca dhe të nxitet inovacioni në tregun e dërgesave të emigrantëve. Kjo përfshin ndalimin e kontratave të ekskluzivitetit për agjentët dhe nënagjentët e dërgesave të emigrantëve</p>
<p>Mbikëqyrje efektive të BSH-së mbi tregun e pagesave me vlerë të vogël</p>	<p>Të sigurohet që kontratat që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet, si për ofruesit e shërbimit dhe përdoruesit, të jenë të përcaktuara qartë dhe zbatohen.</p>
	<p>Të mbahet një regjistër i agjentëve të përdorur nga bankat dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave. Ky regjistër të jetë publik dhe i disponueshëm për konsumatorët</p>

➤ [Ligji 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”](#)

- **Rishikimi i rregulloreve për funksionimin e sistemit AIPS dhe AECH si dhe vlerësimi i sistemeve sipas parimeve mbikëqyrëse të Bankës për Rregullime Ndërkombëtare (BRN) dhe Bankës Qendrore Evropian (BQE) mbështetur nga Banka e Italisë.**

Nëpërmjet rishikimit të kuadrit rregullativ për funksionimin e sistemit AIPS dhe AECH ku janë reflektuar dhe një sërë nga gjetjet e vlerësimit të sistemeve sipas parimeve mbikëqyrëse të BRN dhe BQE, janë përmbytur një sërë masash ashtu si mund të evidentohet edhe nga paraqitja e tabelës në vijim.

Konsolidimi i mjedisit rregullator lehtësues për pagesat me vlerë të vogël	Rregulloret dhe rregullat e tjera për gjithë infrastrukturën e sistemit të pagesave në vend do të garantojnë akses të drejtë dhe të hapur. Atje ku të jetë e nevojshme, do të ndiqen reforma ligjore.
	Operacionalizimi i kategorisë së “pjesëmarrjes së tërthortë” në AECH.
	Të analizohet mundësia për të kolateralizuar “ex ante”/ paraprakisht pozicionet neto të debitit të shkaktuara nga pjesëmarrësit e AECH-ut. Të analizohet gjithashtu vendosja e limiteve për pozicionet neto të debitit të pjesëmarrësve të AECH-ut.
	Vlerësim i detajuar i AIPS dhe AECH në bazën e CPMI-IOSCO të PITF: përgatitja e një vetëvlerësim të detajuar; kryerja e një vlerësim të jashtëm.
	Sistemet e pagesave të operuara nga sektori privat zbatojnë masa të rrepta për administrimin e rrezikut.
Mbikëqyrje efektive të BSH-së mbi tregun e pagesave me vlerë të vogël	Të sigurohet që ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe operatorët e sistemit të pagesave të rishikojnë rregullisht strukturën e tyre të kostove dhe çmimeve. (<i>Homebanking</i>)

- [Rregullore 35/2020 "Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël \(AECH\)"](#)
- [Rregullore 36/2020 "Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS"](#)

- *Rinovimi i kartave biometrike nga Qeveria Shqiptare vlerësohet se mbështetur objektivat e strategjisë për shkak të inovacionit të promovuar*

Konsolidimi i mjedisit rregullator
lehtësues për pagesat me vlerë të
vogël

Të sigurohet përfundimi i rinovimit të kartave të identifikimit
biometrike, filluar në vitin 2009.